



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:132360
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05590470

AC.nr.1334/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, nga gjyqtari individual Besnik Feka, në çështjen përmbarimore të kreditorit H. H. G., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës me seli në Prishtinë, lidhur me përmbarimin e borxhit në vlerë prej 562.88 €, duke vendosur në lidhje me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1501/20 i datës 20.01.2023, me datë **18.04.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit H. H.-G., ushtruar përmes të autorizuarit të saj avokat Sylejman Klinaku nga Prishtina, **NDRYSHOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1501/20, i datës 20.01.2023, ashtu që refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri për Lejimin e Përmbarimit i Përmbaruesit Privat P.nr.979/20 i datës 28.05.2020 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr. 1501/20, i datës 20.01.2023, në dispozitiv të aktvendimit pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, dhe SHFUQIZOHET Urdhëri Përmbarimor P.nr.979/20 i datës 28.05.2020, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Afet Mjeku, nga Prishtina.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet në tërësi ankesa e kreditorit dhe të shfuqizohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të detyrohet debitori që t'ia paguaj kreditorit borxhin sipas propozimit, me kamat ligjore prej 8% nga dita e dorëzimit të propozimit për Përmbarim, apo çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjykata e Apelit të Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, fillimisht duke u kujdesur për kompetencën e saj lëndore dhe funksionale, konstaton se ka kompetencë lëndore bazuar në nenin 3 par.2 të Ligjit për Procedurë Përmbartimore e gjithashtu edhe funksionale ku përcaktohet se në shkallën e dytë në procedurën përmbartimore vendos gjyqtari individual i gjykatës së shkallës së dytë, për vendosje sipas ankesës së ushtruar.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, në lidhje me nenin 201 pika b) dhe d), nenin 208 dhe neni 209 pika c) të LPK-së gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Fillimisht kompetenca lëndore e kësaj Gjykate është përcaktuar me nenin 77 par.2 dhe 4 të LPP-së, ndërsa kompetenca funksionale e kësaj Gjykate është përcaktuar në nenin 3 par.2 të LPP-së ku përcaktohet se vendimet lidhur me ankesat në procedurë përmbartimore në shkallën e dytë i nxjerr Gjyqtari Individual i asaj Gjykate.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 28.05.2020, ka paraqitur propozim pranë organit përmbartues për caktimin e përmbartimit në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës.

Organi përmbartues me urdhrin, P.nr.1858/2020, i datës 28.05.2020 e ka lejuar përmbartimin.

Debitori pas pranimit të urdhrin për përmbartim ka ushtruar propozim pranë Gjykatës së shkallës së parë me propozim që të aprovohet propozimi ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

I autorizuari i kreditorit av. Sylejman Klinaku, ka ushtruar përgjigje në propozimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që propozimin në fjalë ta refuzoj të pabazuar dhe të vërtetoj Urdhërin për Lejimin e Përmbartimit.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.1501/2020, i datës 20.01.2023, e ka pranuar propozimin të debitorit dhe e ka shfuqizuar Urdhrin për lejimin e Përmbartimit të Përmbartuesit Privat, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të saj gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shikimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se në rastin konkret vendimi i Inspektoriatit të Punës nr.21-1715/94 i datës 10.02.20 dhe Vendimi korrigjues numër 303/2020 i datës 19.05.2020 nuk është dokument përmbartimor dhe nuk i përmbushë tiparet e përmbartueshmërisë konform nenit 27 të LPP-së në lidhje me nenin 24 par.3 të LPP-së. Tutje Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka theksuar se Inspektoriatit i Punës sipas Ligjit nr.2002/09 gjegjësisht nenit 2 të këtij ligji nuk ka autorizim dhe kompetencë për të nxjerr vendime që përmbajnë detyrime monetare apo të drejta të kthimit të punëtorit në punë andaj mbi këtë bazë dhe arsye të lartë cekura e njëjta gjykatë ka vlerësuar se Vendimi i Inspektoriatit të Punës për njohjen e pagave jubilarë të debitorit nuk është vendim përmbartimor sipas rregullave të përcaktuara të nenit 24 par.3 të LPP-së në lidhje me nenin 27 par.1 të LPP-së, kjo për faktin se dokumenti përmbartimor nuk përcakton shumën e detyrimeve, por vetëm konstaton detyrime të cilat nuk mund të përmbartohen, andaj në bazë të nenit 73 të LPP-së ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar

Gjykata e Apelit të Kosovës nuk mund ta pranojë qëndrimin dhe mënyrën e vendosjes së Gjykatës së shkallës së parë, pasi që vlerëson se gjykata e shkallës së parë konform nenit 183 par.1, në lidhje me nenin 194, 195 par.1 pika e), në lidhje me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së, gabimisht ka vlerësuar shkresat e lëndës të cilat kanë rezultuar me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë me aprovimin e ankesës së të autorizuarit të kreditorit Av. Sylejman Klinaku nga Prishtina vlerëson se Vendimi i Inspektoriatit të Punës

nr.21-1715/94 dhe vendimi korrigjues nr. 303/2020 i datës 19.05.2020 është vendim përmbartimor pasi që i njëjti përmbanë të gjitha kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave mund të përcaktohet shuma e kredisë së kreditorit H. H.-G., ngase në pikën 1 të këtij vendimi është përcaktuar detyrimi i debitorit SHSKUK-QKUK -Prishtinë që të paguaj pagën shpërblimin jubilar punonjësve të tij,në mesin e të cilëve edhe kreditorit H. H.-G..Ky vendim është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me të njëjtën datë dhe atë 19.05.2020.

Nga lista e pagave e cila është lëshuar nga debitori si punëdhënës,përcaktohet lartësia e pagës neto të kreditorit H. H.-G.në shumë prej 562.88 €,si dhe parashihet përvoja e saj e punës prej mbi 10 vite.

Gjykata e shkallës së dytë nga të gjitha këto prova vlerëson se vendimi i nxjerr në procedurën administrative nga Inspektoriati i Punës nga rivlerësimi i provave në shkresat e lëndës bazuar në nenin 27 par.1 në lidhje me nenin 24 par.3 të Ligjit për procedurën përmbartimore numër 04/L-139 është dokument përmbartimor dhe është i përshtatshëm për përmbartim pasi që edhe nga lista e pagave që disponon debitori edhe nga ekspertiza financiare në përputhje të plotë në pikën 1. të vendimit të Inspektoriatit të Punës,po ashtu edhe në nenin 17 par.3 nën par.3.2 të kontratës kolektive sektoriale të Shëndetësisë si dhe paragrafit 4 të nenit të 17 të kësaj kontrate përcaktohen vetëm vlera në lartësi të një page mujore që debitori si punëdhënës duhet t'ia paguajë kreditorit si punëmarrës në emër të kohëzgjatjes së tij të punës,ndërsa nuk përcaktohet lartësia monetare (në numra) mirëpo kjo mbetet të përcaktohet me prova tjera ,e të cilat kreditori nga shkresat e lëndës konstatohet se i ka dorëzuar dhe janë evidente në shkresat e lëndës.

Sipas nenit 27 par.1 të LPP-së një dokument përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftëse komulativisht plotësohen këto kriteret,dhe atë në atë dokument është treguar kreditori dhe debitori,si dhe objekti,mjetet,shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.Në dokumentin përmbartimor-Vendimin e Inspektoriatit të punës nr.21-1715/94 dhe vendimi korrigjues nr. 303/2020 i datës 19.05.2020,përcaktohen palët,objekti dhe koha e përmbushjes ndërsa shuma e kredisë është përcaktuar në vlerë të një page jubilar,e cila shëndrrohet në vlerë numerike financiare me provat dhe atë listën e pagave ku përcaktohet lartësia e pagës neto të kreditorit dhe me ekspertizën financiare e cila e zbërthen dhe e kompletton dokumentin përmbartimor duke saktësuar shumën e kredisë që debitori në bazë të nenit 17 par.3 nën par.3.2 në lidhje me nenin 4 të kontratës sektoriale të shëndetësisë e cila ka qenë në fuqi në kohën e njohjes së kësaj të drejte nga Përmbartuesi Privat,pasi që e njëjta është lidhë më 11.06.2018 dhe është nënshkruar të njëjtën datë po ashtu ka prodhuar efekt juridik që nga ajo datë,ashtu që e njëjta sipas nenit 2 par.1 të kësaj kontrate ku është përcaktuar vlefshmëria e saj në kohëzgjatje prej 3 vitesh,llogaritet se e njëjta ka qenë në fuqi deri me datën 11.06.2021.

Gjykata e Apelit vlerëson se referuar nenit 27 par.1 të LPP-së përveç të plotësimit të kushteve të tjera i njëjti është i përshtatshëm për t'u përmbartuar edhe kur shuma e kredisë është e caktueshme (në lartësi të një page jubilar) dhe e njëjta shumë si detyrim caktohet në vlerë numerike-shumë monetare me provat përkatëse siç është në rastin konkret lista e pagës e lëshuar nga debitori për kreditorin si dhe ekspertiza financiare e autorizuar nga organi përmbartues.

Sa i përket detyrimit të caktueshëm i cili sipas ligjit rrjedh nga ndonjë punë juridike, vendim i një organi gjyqësor apo administrativ dhe i njëjti nuk është përcaktuar në vlerë monetare, porse përmbanë të dhëna apo elemente në bazë të të cilave mund të caktohet, kjo përcaktohet me nenin 38 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, në të cilin parashihet citoj **“Objekti i detyrimit është i caktueshëm në qoftë se kontrata përmban të dhënat me ndihmën e të cilave mund të caktohet objekti, apo nëse palët ia kanë lënë personit të tretë që ta caktojë objektin”**, atëherë, nga kjo mund të vihet në përfundim se në rastin konkret edhe pse detyrimi nga dokumenti përmbartimor-vendimi i Inspektoriatit të Punës për pagesën e pagave jubilarë kreditorit në përputhje me kohëzgjatjen e përvojës së tij të punës në rastin konkret për pagesën e

një page neto në shumën prej 562.88 euro, është i caktueshëm, i njëjti përmbanë të gjitha elementet e duhura nga të cilat mund të caktohet dhe është caktuar përmes provave relevante dhe atë listës së pagës së kreditorit dhe ekspertizës financiare

Prandaj Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesës së autorizuarit të kreditorit, rivlerësimit të provave në shkresat e lëndës vlerëson se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke aprovuar ankesën e kreditorit, duke e ndryshuar aktvendimin e ankimuar duke e refuzuar prapësimin e debitorit ashtu që edhe ka vërtetuar Urdhërin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat.

Prandaj Gjykata e Apelit në vështrim të nenit 183 par.1, nenit 194, nenit 201 pika b) dhe d), në lidhje me nenin 208 dhe 209 pika c) të LPK-së në lidhje me nenin 17 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.1334/23, me datë 18.04.2024

Gjyqtari Individual
Besnik Feka